

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Valon Totaj – kryetar i kolegjit, Gani Avdiu e Zenel Leku – anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit R.K. nga fshati ... – komuna e Gllogocit, të cilin e përfaqëson i autorizuari i tij av.A.H. nga Gllogoci, kundër të paditurës Komuna e Gllogocit – Drejtoria Komunale e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, të cilën e përfaqëson avokatura shtetërore pranë Ministrisë së Drejtësisë, për shkak të pagesës së tri pagave bazë për shpërblimin jubilar si dhe tri pagave mesatare për përcjellje në pension, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Gllogoc C.nr.257/17, të datës 10.04.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 05.11.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurës Komuna e Gllogocit – Drejtoria Komunale e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Gllogoc C.nr.257/17, i datës 10.04.2018, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.257/17, të datës 10.04.2018, e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit R.K. nga fshati, komuna e Gllogocit si të bazuar dhe e ka detyruar të paditurën komuna e Gllogocit – Drejtoria komunale e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, që në emër të tri pagave të fundit me rastin e shkuarës në pension dhe tri pagave jubilarë nga përvoja e punës t’ia paguaj paditësit shumën prej 2.598 €, me kamatë ligjore prej 8 % në vit duke filluar nga data 21.08.2017, kur paditësi ka parashtruar padinë në gjykatë e deri në pagesën definitive si dhe e ka detyruar të paditurën t’ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 280 €, të gjitha këto në afatin prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e nën kanosjen e përmbarimit ligjor.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor e paditura ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën e të paditurës komuna e Gllogocit si të bazuar me ligj, ta prish aktgjykimin e goditur me këtë ankesë C.nr.257/17, të datës 10.04.2018 dhe ta refuzoj padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar në ligj.

Paditësi brenda afatit ligjor ka parashtruar përgjigje në ankesë me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta refuzoj si të pathemeltë ankesën e të paditurës komuna e Gllogocit – Drejtoria Komunale e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe ta vërtetoj aktgjykimin e atakuar C.nr.257/17, të datës 10.04.2018.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- ankesa e të paditurës është e **pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi R.K. me datë 21.08.2017, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurës komuna e Gllogocit – Drejtoria Komunale e Shëndetësisë dhe e Mirëqenies Sociale, për shkak të tri pagave bazë për shpërblim jubilar dhe tri pagave mesatare për përcjellje në pension, më arsye sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të prezantuara nga palët ndërgjyqëse, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor e ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.257/17, të datës 10.04.2018, me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar gjykata ka theksuar se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura me detyrat e punës infermier me kohë të pacaktuar duke filluar nga data 01.01.2012, gjithashtu theksoi se paditësi ka filluar punën te e paditura me datë 01.08.1972, në punët dhe detyrat e teknikut medicinal deri me datë 05.04.2017, kur është pensionuar. Më tutje gjykata theksoi se paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës me datë 05.04.2017, në bazë të fuqisë ligjore nga se e mbush moshën e pensionit përkatësisht 65 vite ndërsa ka realizuar pagën mujore prej 433 €. Lidhur me bazën juridike të kërkesëpadiës gjykata i'u ka referuar Ligjit të Punës nr.03/L-212 dhe nenit 52 dhe 53 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, ndërsa sa i përket kamatës gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitën e nenit 382 të LMD-së. Për shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në bazë të nenit 449 paragrafi 1 dhe 2 i LPK-së, nenit 12 paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ të KGJK-së për Unifikimin e Taksave Gjyqësore.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të pretenduara dhe as në shkeljet nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadiës e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se

si janë vërtetuar faktet, përveç atyre jo kontestuese, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Edhe gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë. Gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar se nga kontrata e punës e lidhur në mes të paditësit dhe të paditurës nr.02.120-4853, e datës 11.04.2012, e lëshuar nga QKMF në Glllogoc, paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura dhe se nga aktvendimi nr.02/36, i datës 26.01.2017, i është ndërprerë marrëdhënia e punës me datë 05.04.2017, për shkak të arritjes së moshës 65 vjeçare.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale për arsyeje se me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 të datës 01.11.2010, përcaktohet se *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve. Me paragrafin 1 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive mund të lidhet a) të nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës. Me paragrafin 4 përcaktohet se Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive”*.

Me nenin 52 par.1, të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të datës 18.03.2014, përcaktohet se *“I punësuar, ka të drejtë në shpërblimin jubilar dhe atë: a) për 10 vjet të përvojës në punë pandërprerë, të punëdhënësi i fundit, në vlerë të një paga mujore të tij; b) për 20 vjet të përvojës në punë pandërprerë, të punëdhënësi i fundit, në vlerë të dy paga mujore të tij dhe c) për 30 vjet të përvojës në punë pandërprerë, të punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij. Me paragrafin 2 të kësaj Marrëveshje për caktohet se: “punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë”, ndërsa në paragrafin 3 të kësaj Marrëveshje përcaktohet se *“Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf”*.*

Me nenin 53 të kësaj Marrëveshje përcaktohet se *“I punësuar, me rastin e pensionimit, gëzon të drejtën në pagesën përcjellëse në lartësi prej tri (3) paga mujore, që i ka marr për tre (3) muajt të fundit”*. Tutje, me nenin 36 paragraf 9, të Kontratës Kolektive (sektoriale) të datës 11.04.2014, përcaktohet se: *“Punëtorët që dalin në pension përfshinë pensionin jubilar në vlerë: a) për 10 vjet të përvojës së punës të punëdhënësi i fundit në vlerë të një page bazë, b) për 20 vjet të përvojës së punës të punëdhënësi i fundit në vlerë të dy paga bazë, c) për 30 vjet të përvojës së punës të punëdhënësi i fundit në vlerë të tri pagave bazë, d) punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblimin jubilar dhe e) shpërblimi jubilar paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve”*. Andaj mbi bazën e tërë të lartecukurave kjo gjykatë gjeti se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka aprovuar kërkespadinë e paditësit si të bazuar në tërësi, për çka edhe vendosi që të njëjtin ta vërtetoj sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera ankimore mirëpo gjeti se të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, e në pajtim me nenin 194, 195 paragrafi 1, pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.2195/18, me datën 05.11.2018

Kryetari i Kolegjit - Gjyqtari,
Valon Totaj